



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

**Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

Tiranë, më 17.02.2021

**RAPORT**

**PËR DEKRETIN E PRESIDENTIT NR. 11942, DATË 27.01.2021, “PËR KTHIMIN E  
LIGJIT NR. 162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK””.**

**-HYRJJE**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 17.02.2021 shqyrtoi Dekretin e Presidentit nr. 11942, datë 27.01.2021, “Për kthimin e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik””.

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, u miratua nga Kuvendi në seancën e datës 23 dhjetor 2020.

Ligji nr.162/2020 është përgatitur bazuar në Direktivën e BE 2014/24, Direktivën 2014/25 dhe Direktivat 89/665 EFC, 92/13/EEC 2007/66/EC mbi mjetet juridike dhe rishikimin administrativ, me synim përafrimin e legjislacionit shqiptar të prokurimit me acquis përkatëse të BE-së.

Hartimi i këtij ligji ka qënë një nga rekomandimet e lëna nga Komisioni Evropian, në mënyrë të vazhdueshme, në Progres Raportet vjetore për Shqipërinë.

Në këtë kontekst hartimi i Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, është konsideruar si një zhvillim pozitiv dhe në Progres Raportin e vitit 2020 të Komisionit Evropian për Shqipërinë, ku theksohet se ligji i prokurimit përcakton në mënyrë të qartë parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe mos diskriminimit.

Theskojmë se në metodologjinë e re të Komisionit Evropian, Kapitulli nr. 5 “Prokurimi Publik”, është vendosur të jetë në grupin e kapitujve të vlerësuar si kapitujt themelorë, që duhet të plotësojnë kushtet, për t’i hapur rrugën negociimit të kapitujve të tjerë.

Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, synon të përmirësojë kuadrin rregullator të prokurimit publik në Shqipëri.

Projektligji është ndarë dhe konsultuar që në draftet e para, me ekspertë të SIGMAs dhe DG Grow në Komisionin Evropian, të cilët kanë vlerësuar draftin e konsultuar si një draft që sjell përmirësime të ndjeshme në rregullimin e sistemit të prokurimit publik dhe përafrim me Direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian.

Projektligji ka kaluar procesin e konsultimit publik në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, duke u publikuar njëkohësisht në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik si dhe faqen zyrtare të APP, duke filluar që nga data 24.12.2019.

Me qëllim hartimin e një ligji sa më të mirë dhe që reflektonte mendimet dhe sugjerimet e të gjithë palëve, ky ligj është konsultuar për më shumë se tre muaj, duke pritur mendime si nga organizatat ndërkombëtare dhe donatorë të huaj, ashtu dhe nga të gjithë institucionet publike, operatorët ekonomikë, shoqëria civile, dhe çdo aktor tjetër i interesuar.

Gjithashtu gjatë procesit të konsultimit publik, janë organizuar disa takime konsultative me grupet e interesit, konkretisht: me përfaqësues të Kontrollit të Lartë të Shtetit, përfaqësues të Shoqatat e Biznesit, përfaqësues nga shoqëria civile dhe donatorët e huaj, përfaqësues të organizatave jofitimprurëse që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e shërbimeve sociale, si dhe me përfaqësues të njësive të qeverisjes vendore.

Në kuadër të procesit të konsultimit publik, projektligji i është dërguar, gjithashtu, për mendim organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare si: Delegacioni i Bashkimit Europian në Tiranë, Banka Botërore, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, dhe Këshilli i Europës.

Grupi i punës ka shqyrtuar dhe vlerësuar me kujdes të gjitha komentet dhe sugjerimet e marra gjatë konsultimit publik, si në takimet e organizuara, ashtu dhe ato të dërguara në adresë të saj me e-mail apo rrugë shkresore, duke përgatitur përgjigjet për secilën prej tyre.

Vlen të theksohet se, një ndihmë të veçantë në përmirësimin e projektligjit kanë dhënë komentet e sugjerimet e Delegacionit të Bashkimit Europian në Tiranë, Bankës Botërore, Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, dhe Këshillit të Europës.

Gjithashtu, janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë dhe reflektuar disa prej mendimeve dhe sugjerimeve të dhëna nga Komisioni i Prokurimit Publik, ILDKPKI, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve Konsulentë, dhe disa operatorë ekonomikë.

Po kështu në hartimin e këtij projektligji kanë dhënë mendim dhe kontribut të gjitha ministrinë e linjës dhe tre Komisione Parlamentare.

Në asnjë moment gjatë këtij procesi të gjatë konsultimi publik, nuk është ngritur asnjë nga pretendimet e parashtruara nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

Thënë sa më sipër, vlen të theksohet se komentet dhe sugjerimet e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, jo vetëm që janë të pabazuara, por janë dhe të paprecedentë pasi Presidenti i Republikës në këtë rast ka marrë përsipër të komentojë nenet e Direktivave të sipërpërmendura të BE-së, duke vlerësuar në mënyrë indirekte se këto nene, synojnë të “...lënë hapësira për zbatim selektive në praktikë të rregullimeve, çojnë në deformimin e konkurrencës së lirë mes operatorëve ekonomikë potencialë për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit. Deformimi i konkurrencës shkakton pasoja direkte në cilësinë e mallit/shërbimit të prokuruar, që ka impakt direkt dhe kosto financiare, duke ulur transparencën e administrimit të fondeve publike...”

Të gjitha nenet e komentuar në Dekretin e Presidentit të Republikës si nene potenciale për mungesë transparence, kufizim të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, apo për abuzim me funksionin publik, janë nene të huazuara nga Direktivat e BE-së, gjë që është lehtësisht e verifikueshme, në tabelat e përputhshmërisë që shoqërojnë ligjin.

Një fakt i tillë vërtetohet dhe nga fakti se Komisioni përkatës për Integrimin Evropian, i ka konsideruar të gjitha nenet e përmendura nga Presidenti i Republikës, në përputhje me nenet përkatëse të Direktivave të BE-së.

Qëllimi i këtij projektligji është të përmirësojë kuadrin rregullator të prokurimit publik në Shqipëri, duke marrë në konsideratë gjetjet dhe rekomandimet e ndryshme të organizmave ndërkombëtarë, si: Komisioni Evropian, Banka Botërore, OECD/SIGMA, etj, duke lehtësuar procesin e prokurimit, si për autoritetet kontraktore, ashtu edhe për operatorët ekonomikë.

Ligji për prokurimin publik është një ndër instrumentet kryesore strategjike që ndihmon qeverinë të arrijë objektivat ekonomikë, socialë dhe të mjedisit nëpërmjet një sistemi të përgjegjshëm, efektiv dhe transparent të mirëpërdorimit të fondeve publike dhe shpenzimeve të qeverisë.

Bazuar në nenin 85 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Presidenti i Republikës ka depozituar pranë Kuvendit, dekretin nr. 11942, datë 27.01.2021, “Për kthimin e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik””.

Komisioni për Çështjet Ligjore e shqyrtoi Dekretin bazuar në nenin 86 të Rregullores së Kuvendit. Bazuar në nenin 26, pika 7, të Rregullores së Kuvendit, ky dekret u përfshi automatikisht në programin e punës së Kuvendit.

## **I. BAZA LIGJORE PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**

### **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:**

#### **Neni 85**

1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.
2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

## **Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë:**

### **Neni 86**

#### **Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji**

1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht. Dekreti i Presidentit për rishqyrtim ligji futet automatikisht në programin e punës së Kuvendit.
2. Dekreti për kthimin e ligjit për rishqyrtim bëhet pjesë e rendit të ditës të mbledhjes më të parë.
3. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës.
4. Komisioni përgjegjës përgatit raportin për seancën plenare me propozimin për pranimin ose rrëzimin e dekretit të Presidentit brenda 4 javëve nga data e depozitimit të tij në Kuvend. Në rastin e pranimit të dekretit, raporti përmban formulimet për nene të veçanta të ligjit.
5. Dekreti për kthim për rishqyrtim të ligjit bëhet pjesë e rendit të ditës të seancës plenare, por jo më parë se 48 orë.
6. Seanca plenare e shqyrton dekretin për kthim për rishqyrtim të ligjit vetëm për arsytet e kthimit të tij.
7. Kuvendi në seancë plenare voton me shumicën e kërkuar në Kushtetutë për pranimin ose rrëzimin e dekretit.
8. Në rast pranimi të dekretit, Kuvendi voton në parim propozimet që Komisioni përgjegjës ka paraqitur në raport. Kuvendi voton vetëm nenet që reflektojnë propozimet e miratuara në komision, si dhe bëhet votimi në tërësi për ligjin.
9. Ligji i votuar në tërësi mban numrin që ka marrë me miratimin e parë, kurse data do të jetë e votimit më të fundit në tërësi.

## **II. DISKUTIMI I DEKRETIT TË PRESIDENTIT NË KOMISIONIN PËR ÇËSHTJET LIGJORE**

Në mbledhjen e Komisionit për shqyrtimin e Dekretit ishin të pranishëm z. Bledar Dervishaj dhe znj. Katrin Treska, përfaqësues të institucionit të Presidentit të Republikës.

Përfaqësuesit e institucionit të Presidentit, paraqitën në mënyrë të përmbledhur argumentet për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Në vazhdim të diskutimit, relatorja znj. Klotilda Bushka dhe anëtarë të Komisionit paraqitën opinionin e tyre lidhur me argumentet e paraqitura nga Presidenti i Republikës në Dekret. Lidhur me çështjet e ngritura në Dekretin e Presidentit të Republikës, argumentet dhe vlerësimet jepen më poshtë.

## **III. ARGUMENTET E PARAQITURA NË DEKRETIN N.11942, DATË 27.01.2021 PËR KTHIMIN NË KUVEND PËR RISHQYRTIM TË LIGJIT NR.162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK”, SIDHE VLERËSIMI I TYRE NGA RELATORJA :**

Para shqyrtimit të argumenteve të veçanta të paraqitura në Dekret, fillimisht konstatohet dhe vlerësohet se:

1. Argumentet e Presidentit më se shumti janë argumente që nuk kanë lidhje me dispozitat e ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, por që shtjellohen në formën e opinioneve me karakter politik mbi mënyrën se si Presidenti e percepton ose dëshiron ta perceptojë veprimtarinë e institucioneve publike te prokurimit në vend; aspak në referim me Direktivave përkatëse të Bashkimit Evropian për përafrimin e sistemit të prokurimit publik sipas dispozitave te legjislationit të Bashkimit Evropian.
2. Të gjitha nenet e komentuara prej Presidentit si nene potenciale *për mungesë transparence, kufizim të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, apo për abuzim me funksionin publik*, janë nene të huazuara nga Direktivat e BE-së, gjë që ishte lehtësisht e verifikueshme, në tabelat e përputhshmërisë që shoqërojnë ligjin.
3. Për sa i takon Komisionit për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, detyra e tij është të shqyrtojë argumentet e Presidentit vetëm për çështjet që kanë të bëjnë me dispozitat e ligjit “Per Prokurimin Publik”.

Në vijim paraqiten arsyet pse nuk qëndrojnë argumentat e Presidentit.

### **Argumenti I: “Mbi fushën e zbatimit dhe përjashtimet”**

Presidenti në dekretin e tij argumenton se “*ankandi elektronik*” do përdoret si mënyrë për të prokuruar, ndërkohë që aktualisht ankandi, duke iu referuar ankandit public, është një procedurë që përdoret për realizimin e shitjes publike nëpërmjet procedurës së ankandit nga autoriteti shitës, procedurë kjo që rregullohet me ligjin nr, 9874, date 14.22008 “Për ankandin publik”, i ndryshuari. Sipas arsyetimit të Presidentit, është tërësisht e paqartë se përse parashikohet në ligjin e prokurimit, ankandi, jo si procedurë e mëvetshme, por si mjet për realizimin e prokurimit.

### **Kundërshtimi:**

Presidenti komenton dispozitat për zhvillimin e ankandit elektronik të parashikuara përkatësisht në nenin 4/2 dhe nenin 54, si nene të panevojshme dhe të paqarta në kushtet kur ka një ligj të posacëm për “*ankandin publik*”. Do mjaftonte një lexim pak më i vëmendshëm dhe profesional i neneve përkatëse për të kuptuar që si nocioni ashtu edhe procesi i ankandit elektronik nuk mbartin aspak lidhje me nocionin dhe tipologjinë e ankandit publik, për të cilin ka një ligj në fuqi. Duhet bërë e qartë rëndësia e dallimit fundamental se realizimi i procesit të prokurimit publik nëpërmjet ankandit elektronik është një procedurë në të cilën pala publike angazhohet **të blejë** produkte apo shërbime nga sektori privat si dhe synon të blejë në kushte sa më të favorshme për sa i përket cmimit në raport me cilësinë. Në të kundërt, në procesin e ankandit publik, kemi një situatë në të cilën shteti, pra pala publike, ka si synim dhe angazhohet **t’i ofrojë për shitje** sektorit privat produkte duke synuar të shesë sa më shtrenjtë. **Për më tepër, nocioni i ankandit elektronik, është një nocion që është marrë në Direktivat përkatëse të BE-së (Neni**

35 i Direktives 2014/24 dhe Neni 53 i Direktives 2014/25) dhe njëkohësisht ekziston si koncept edhe në dispozitat e ligjit të shfuqizuar nr. 9643/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me emërtimin “blerje elektronike”; në dispozitat e të cilit i referohet procesit që përfshin një mënyrë elektronike të paraqitjes së cmimeve të reja, me qëllim marrjen e cmimit më të ulët, për rastet kur është i aplikueshëm. Sa më sipër, duhet theksuar se ligji për ankandin publik do të vijojë të jetë në fuqi.

**Argumenti II:** Presidenti pretendon se në rregullimin e rasteve të prokurimit të përzier që mbulon disa veprimtari, përcaktuar në nenin 6, ligji nuk parashikon asnjë mekanizëm konkret për të normuar vendimmarrjen e vetë autoritetit apo entit kontraktor në përzgjedhjen e njëres procedure prokurimi në raport me tjetrën, dhe nënshtrimit të kesaj procedure sipas rregullave të ligjit për prokurimin publik, ligjit për koncesionet, apo ligjit për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Më tej, Presidenti arsyeton se ky lloj parashikimi i bërë në nenin 6 të ligjit, lë hapësira për mosevidentimin në mënyrë korrekte nga autoriteti kontraktor, me përfshirjen e elementëve të klasifikuar, të zhvillohet si procedurë prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, duke shmangur transparencën e procesit dhe duke kufizuar njëkohësisht dhe pjesëmarrësit në një konkurim.

### **Kundërshtimi:**

Kontratat, që kanë si objekt të tyre dy ose më shumë lloje prokurimi për punë, shërbime ose furnizime, jepen në përputhje me dispozitat e zbatueshme, sipas llojit të prokurimit që karakterizon objektin kryesor të kontratës në fjalë. Për këtë, në rastin e kontratave të përziera, që përbëhen pjesërisht nga shërbimet e parashikuara në kreun XII të ligjit 162/2020 dhe nga shërbime të tjera, ose kontrata të përziera, që përbëhen pjesërisht nga shërbimet dhe pjesërisht nga furnizimet, objekti kryesor përcaktohet në përputhje me vlerën më të lartë të parashikuar për shërbimet ose furnizimet përkatëse.

Prokurimi i përzier mund të mbulojë disa veprimtari. Prandaj, në kuadër të garantimit të sigurisë juridike të ligjit, dallohet se për kontratat publike që kanë si objekt të tyre dy ose më shumë veprimtari, prokurimi i të cilave rregullohet në regjime të ndryshme, kur pjesë të ndryshme të saj janë objektivist të ndashme, autoritetet ose entet kontraktore mund të zgjedhin të japin disa kontrata të ndara për secilën prej tyre ose të japin një kontratë të vetme, kur për arsye objektive, është i pamundur prokurimi në kontrata të ndara. Në çdo rast, dispozitat e ligjit parashikojnë se zgjedhja midis prokurimit të një kontrate të vetme dhe prokurimit të disa kontratave të ndara nuk duhet të bëhet me qëllimin për ta përjashtuar kontratën ose kontratat nga fusha e zbatimit të këtij ligji. Në rastet kur autoritetet ose entet kontraktore zgjedhin të japin kontrata të ndara, vendimi për rregullat që zbatohen për secilën prej tyre merret mbi bazën e karakteristikave të veprimtarisë së veçantë përkatëse.

Në ato raste kur autoritetet ose entet kontraktore zgjedhin të japin një kontratë të vetme, në rastin e kontratave, të cilat kanë si objekt prokurimin që mbulohet nga sektori klasik dhe prokurimin për kryerjen e një veprimtarie sektoriale, rregullat e zbatueshme përcaktohen sipas dispozitave që rregullojnë sektorin klasik.

Në rastin e kontratave të përziera, që përmbajnë elemente të kontratave të furnizimit, punëve dhe shërbimeve sipas këtij ligji dhe ligjit të koncesioneve, kontrata e vetme jepet në përputhje me këtë ligj, nëse vlera e parashikuar e pjesës së kontratës që mbulohet nga ky ligj, e llogaritur në përputhje me parashikimet e këtij ligji, është e barabartë ose më e madhe se kufiri i lartë monetar.

Në rastin e kontratave të përziera, që përmbajnë elemente të kontratave të furnizimit, punëve dhe shërbimeve sipas këtij ligji dhe sipas ligjit të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, kontrata e vetme jepet në përputhje me rregullat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Gjithnjë sipas dispozitave të ligjit 162/2020, në rastet kur është e pamundur që pjesë të ndryshme të një kontrate publike të përzier të ndahen, kontrata e vetme do të jepet në bazë të rregullave të zbatueshme për objektin kryesor të saj. Ndërsa për kontratat e përziera, për të cilat është e pamundur të ndahen dhe është e pamundur të përcaktohet se cila veprimtari është objekti kryesor, dispozitat e ligjit 162/2020 parashikojnë se në rastin e kontratave, të cilat kanë si objekt prokurimin që mbulohet nga sektori klasik dhe prokurimin për kryerjen e një veprimtarie sektoriale, rregullat e zbatueshme përcaktohen sipas dispozitave që rregullojnë sektorin klasik.

Në rastin e kontratave të përziera, që përmbajnë elemente të kontratave të furnizimit, punëve dhe shërbimeve të sektorit klasik dhe të koncesioneve, kontrata e vetme jepet në përputhje me ligjin 162/2020, nëse vlera e parashikuar e pjesës së kontratës, e cila përbën një kontratë që mbulohet nga ligji 162.2020, e llogaritur në përputhje me parashikimet e ligjit 162/2020, është e barabartë ose më e madhe se kufiri i lartë monetar.

Në rastin e kontratave të përziera, që përmbajnë elemente të kontratave të furnizimit, punëve dhe shërbimeve të veprimtarive sektoriale dhe të koncesioneve, kontrata e vetme jepet në përputhje me rregullat e parashikuara për prokurimet në veprimtaritë sektoriale sipas dispozitave të ligjit 162/2020.

Ndërsa në rastin e kontratave të përziera, që përmbajnë elemente të kontratave të furnizimit, punëve dhe shërbimeve sipas këtij ligji dhe sipas ligjit të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, kontrata e vetme jepet në përputhje me rregullat e prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. **Për më tepër, dispozitat për kontratat e përziera janë hartuar duke u bazuar në parashikimet e Direktivave të BE-së mbi rregullat e zbatueshme për kontratat e përziera, konkretisht Neni 3 i Direktivës 2014/24 dhe Nenet 5 dhe 6 të Direktivës 2014/25.**

Shpjeguar sa më sipër, pretendimi që ligji nuk parashikon asnjë mekanizëm konkret për të normuar vendimmarrjen e vetë autoritetit apo entit kontraktor në përzgjedhjen e njëres procedure prokurimi në raport me tjetrën, mbetet tërësisht pa bazë.

**Argumenti III:** Në dekretin e Presidentit ngrihet shqetësim për dispozitat e nenit 10 dhe 12 të ligjit 162/2020, mbi kontratat sekrete dhe kontratat që kërkojnë masa të veçanta sigurie, duke pretenduar se dispozitat e këtyre neneve shmangin rregullimet e ligjit 162/2020, pa orientuar se cilat mund të përbëjnë interes thelbësor të shtetit, duke e lënë klasifikimin e sekretit shtetëror në gjykim të një autoriteti apo enti kontraktor.

#### **Kundërshtim:**

Në lidhje me kontratat sekrete dhe kontratat që kërkojnë masa të veçanta sigurie, në dispozitat e ligjit 162/2020 shprehet qartësisht se ligji 162/2020 nuk zbatohet për kontratat publike dhe konkurset e projektimit, në rast se prokurimi ose zbatimi i tyre është klasifikuar sekret shtetëror apo kërkon masa të veçanta sigurie sipas legjislacionit në fuqi, ose në rast se një gjë e tillë diktohet nga interesat thelbësore të shtetit, me kusht që të jetë përcaktuar që interesat thelbësore në fjalë nuk mund të garantohen me vendosjen e kritereve që synojnë mbrojtjen e natyrës së klasifikuar të informacionit, që autoriteti ose enti kontraktor i vë në dispozicion në procedurën e prokurimit. Për sa më sipër, ligji 162/2020 e shpjegon shumë qartë se përcaktimi nëse prokurimi ose zbatimi i tij është klasifikuar sekret shtetëror apo kërkon masa të veçanta sigurie përcaktohet

sipas legjislacionit në fuqi, më konkretisht sipas ligjit nr.8457, datë 11.02.1999 ‘Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror" (Ndryshuar me ligjin Nr. 9541, Datë 22.05.2006) (Ndryshuar me ligjin Nr. 25/2012, Datë 15.03.2012). Pra, legjislacioni në fuqi, dhe jo ligji përgjegjës për prokurimin publik, përcakton rregullat për klasifikimin, përdorimin, ruajtjen dhe deklasifikimin e informacionit për sigurinë kombëtare që konsiderohet sekret shtetëror. Sipas legjislacionit në fuqi shteti është zotëruesi i vetëm i sekreteve shtetërore, duke e rregulluar këtë të drejtë me të drejtën e publikut për t'u njohur me veprimtarinë e tij. **Për më tepër, dispozitat e nenit 10 dhe 12 të ligjit 162/2020 janë marrë nga Neni 15 i Direktivës së BE-së 2014/24 dhe Neni 24 i Direktivës 2014/25.**

**Argument IV:** Dekreti i Presidentit shprehet se dispozitat e nenit 15 të ligjit nr.162/2020 parashikojnë se *“autoritet ose entet kontraktore mund t’u rezervojnë të drejtën e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik operatorëve ekonomik qëllimi kryesor i të cilëve është integrimi social dhe profesional i personave me aftësi të kufizuara ose personave në nevojë me kusht që të paktën 30% e punësuarve të këtyre operatorëve ekonomik ose programeve janë punëtorë me aftësi të kufizuara ose punonjës në nevojë, sipas legjislacionit në fuqi.”*

Më konkretisht, shqetësimi i Presidentit shtjellohet më tej duke aluduar se mbështetja pozitive që parashikohet nga ligji në funksion të integritit social dhe profesional të personave me aftësi të kufizuara, rrezikon të mbetet një parashikim që nuk do të realizohet duke ngelur vetëm deklarativ dhe të mos aplikohet në praktikë.

Për të shmangur këtë situatë, Presidenti i Republikës vlerëson në dekretin e tij se është e nevojshme që dispozitat ligjore të cilat sanksionojnë të drejta për subjekte të caktuara, duhen plotësuar në mënyrë të qartë dhe shteruese, që të mund të aplikohen lehtësisht në praktikë nga subjektet reale të cilëve u adresohen.

#### **Kundershtim:**

Në lidhje me kontratat e rezervuara, ligji nr.162/2020 shprehet qartësisht se autoritetet ose entet kontraktore mund t’u rezervojnë të drejtën e pjesëmarrjes në procedurat e prokurimit publik operatorëve ekonomikë, qëllimi kryesor i të cilëve është integrimi social dhe profesional i personave me aftësi të kufizuara ose personave në nevojë ose të parashikojnë që këto kontrata të zbatohen në kontekstin e programeve për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Kjo kushtëzohet shprehimishtin me kushtin e përcaktuar dhe kuantifikuar shumë qartë që detyrimisht të paktën 30% e punonjësve të këtyre operatorëve ekonomikë ose programeve të jenë punëtorë me aftësi të kufizuara ose punonjës në nevojë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Për më tepër, ligji nr.162/2020 parashikon saktësisht dhe detyrimin e autoritetit ose entit kontraktor, i cili do të kryejë një procedurë sipas parashikimeve të dispozitave të sipër përmendura, për të përcaktuar këtë në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Përsa i përket aftësisë së kufizuar, sjellim në vëmendje se përkufizimi i personit me aftësi të kufizuar në vendin tonë nuk përcaktohet në legjislacionin përgjegjës për prokurimin publik, por se bazohet në legjislacionin e mbrojtjes sociale. Sipas ligjit nr.9355, neni 4, me “Person me aftësi të kufizuar” kuptohet individi, të cilit i është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimit fizik, shqisor, të intelektit, psikiko/mendor, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje të përkohshme apo të përhershme, të cilat nuk vijnë nga shkaqe që lidhen me punësimin. Më tej, ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” është një avancim shumë i rëndësishëm në përcaktimin dhe garantimin e të drejtave thelbësore që lidhen me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim



garantimin e mundësive të barabarta për të gjithë këta persona në kushte të barabarta me të tjerët. Legjislacioni në fuqi parashikon përcaktimet për garantimin e jetesës së pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara që zgjedhin të jetojnë në mënyrë të pavarur, duke rritur në maksimum autonominë e tyre dhe vendimmarrjen e pavarur, me synimin për të garantuar jetën në komunitet në kushte të barabarta me të tjerët. **Për më tepër, dispozitat e nenit 15 të ligjit 162/2020 janë marrë nga Neni 20 i Direktivës së BE-së 2014/24 dhe Neni 38 i Direktivës 2014/25.**

Shpjeguar sa më sipër, pretendimi që dispozitat ligjore të ligjit nr.162/2020 të cilat sanksionojnë të drejta për personat me aftësi të kufizuara janë plotësuar në mënyrë të qartë dhe shteruese si nga ligji nr.162/2020 ashtu edhe nga dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen sociale.

#### **Argumenti V: “Mbi rregullat e përgjithshme të prokurimit dhe komunikimit”**

Dekreti i Presidentit arsyeton se dispozitat e ligjit nr. 162/2020, krijojnë një hapësirë të gjerë për përdorimin e komunikimit shkresor, në raport me atë elektronik.

#### **Kundërshtimi:**

Pretendimi se dispozitat e se dispozitat e ligjit nr. 162/2020, krijojnë një hapësirë të gjerë për përdorimin e komunikimit shkresor, në raport me atë elektronik, nuk është aspak i bazuar sepse dispozitat e ligjit nr.162/2020 krijojnë një hapësirë të gjerë për komunikimin elektronik; ndërkohë që komunikimi shkresor parashikohet në mënyrë përjashtuese në nenin 17; kriteret për rastet kur mund të përdoret komunikimi në rrugë shkresore ligji autorizon për t’u përcaktuar më tej me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me parashikimet e nenit 118 të Kushtetutës. **Për më tepër, dispozitat e nenit 17 të ligjit 162/2020 janë marrë nga Neni 22 i Direktivës së BE-së 2014/24 dhe Neni 40 i Direktivës 2014/25.**

**Argumenti VI:** Dekreti i Presidentit pretendon se dispozitat e nenit 19 të ligjit nr.162/2020 krijojnë një hapësirë të pakufizuar për autoritetet kontraktore për të zgjedhur midis dy lloj vendimmarrjesh, për të zëvendësuar anëtarët, apo, për të anuluar procedurat me nëntekstin e konstatimit të një shtete konflikti interesi që në fund të fundit, mbetet në vlerësimin e autoritetit apo entit kontraktor. Sipas Presidentit hapësira e autoritetit është shumë e gjerë, e pakufizuar dhe për më tepër, kjo mundësi zgjedhjeje për anulimin e procedurës nuk mund të lejohet të kryhet në fazën e hapjes së ofertave. Presidenti arsyeton se rastet e anulimit të procedurës duhet të jenë më strikte dhe të qarta në momentin kur aplikohen.

#### **Kundërshtimi:**

Në lidhje me konfliktin e interesit, dispozitat e nenit 19 të ligjit nr.162/2020 parashikojnë shumë qartë dhe në mënyrë shteruese detyrimin që autoritetet ose entet kontraktore të marrin masat e përshtatshme për të parandaluar, identifikuar dhe zgjidhur në përputhje me legjislacionin në fuqi rastet e konfliktit të interesit që lindin gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit për të shmangur shtrembërimin e konkurrencës dhe për të garantuar trajtimin e barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë.

Për më tepër, në kuadër të eliminimit të konfliktit të interesit, dispozitat e nenit 19 të ligjit ndalojnë që personat e angazhuar në procesin e prokurimit dhe ekzekutimin e kontratës të jenë në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Në këtë kuadër, situata për konfliktin e interesit vlerësohet sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave dhe në kuptim të ligjit nr.162/2020 mbulon çdo situatë ku titullari ose punonjës të autoritetit ose entit kontraktor ose ofruesit të shërbimit të prokurimit, që

vepron në emër të autoritetit ose entit kontraktor, të cilët janë të përfshirë në zhvillimin e procedurës së prokurimit, ose mund të ndikojnë në rezultatin e kësaj procedure kanë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë një interes financiar, ekonomik ose ndonjë interes tjetër personal, që mund të cenojë paanësinë dhe pavarësinë e tyre në vendimmarrjen e procedurës së prokurimit.

Dispozitat e nenit 19 parashikojnë qartësisht se në atë rast në të cilin gjatë fazës së studimit paraprak të tregut, të përgatitjes së dokumenteve të tenderit ose në momentin e hapjes së ofertave evidentohet se një ose disa prej kandidatëve/ofertuesve ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me një ose disa prej zyrtarëve të caktuar për studimin e tregut/përgatitjes së dokumenteve të tenderit apo vlerësimin e kërkesave/ofertave **dhe kjo situatë konflikti nuk mund të evidentohet përpara këtij momenti**, atëherë titullari i autoritetit kontraktor, në varësi të dëmit që mund të jetë shkaktuar, vendos nëse duhet të zëvendësohen anëtarët e komisioneve të konstatuara në kushtet e konfliktit të interesit e të vijojë procesin apo të anulojë procedurën e prokurimit. Këto dispozita garantojnë pa ekuivoke mënjanimin e konfliktit të interesit. Këtu bëhet fjalë vetëm për një skenar të përveçëm në të cilin situata e konfliktit është e tillë që nuk mund të evidentohet përpara këtij momenti. Për rrjedhojë, dispozitat parashikojnë edhe mundësinë për anulimin të prokurimit kur zbulohet konflikti i interesit sepse ligjvënësi e vlerëson konfliktin e interesit si arsye madhore për të cuar në anulimin e prokurimit. Cdo skenar tjetër do të lejonte mundësi për abuzime. **Për më tepër, dispozitat e nenit 19 të ligjit 162/2020 janë marrë nga Neni 24 i Direktivës së BE-së 2014/24 dhe Neni 42 i Direktivës 2014/25.**

**Prandaj, konkludojmë se rastet e anulimit të procedurës në dispozitat e ligjit nr.162/2020 janë të përcaktuara shumë qartë se në çfarë rastesh aplikohen.**

### **Argumenti VII: “Mbi organizimin, funksionimin, statusin dhe vendimmarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik”**

Në Dekretin e Presidentit arsyetohet se formulimi i dispozitave të nenit 24 të ligjit nr.162/2020 e bën të paqartë nëse kjo kompetencë e KPP-së për të bërë interpretimin e rregullave ose parimeve ligjore, ka vlerë dhe fuqi vetëm për çështjen konkrete për të cilën është bërë ankesa, apo do të shërbejë si unifikim praktike nga ky organ që pavarësisht kompetencave që ka në shqyrtimin e ankesave, nuk mund t'i jepet tagri i një organi “quasi-gjyqësor”, për të bërë interpretime me vlerë të detyrueshme nga autoritetet kontraktore.

### **Kundërshtimi:**

Dispozitat e ligjit nr.162/2020 sanksionojnë qartë se Komisioni i Prokurimit Publik (KPK) është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe se KPK merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për aq kohë sa janë të vlefshme në vendimmarrjet e ardhshme. Sipas dispozitave të ligjit nr.162/2020, në marrjen e vendimeve KPK gjithashtu garanton, paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritit. **Për më tepër, dispozitat e nenit 24 të ligjit 162/2020 janë marrë nga Neni 2 i Direktivës së BE-së 89/665 dhe Neni 2 i Direktivës 92/13.**

**Argumenti VIII:** Sipas Dekretit të Presidentit propozimi i listës së kandidatëve për anëtar të KPP për Kuvendin nga Këshilli i Ministrave minon besimin për pavarësi e paanësi të këtij institucioni me rëndësi thelbësore sa i takon vlerësimin të ligjshmërisë në procedurat e prokurimit publik.

### **Kundërshtimi:**

Dispozitat e nenit 25 të ligjit nr.162/2020 përcaktojnë qartë se Kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik emërohen nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave. Më tej procedura detajohet duke përcaktuar shprehimisht se Këshilli i Ministrave, pasi shqyrton aplikimet e paraqitura dhe verifikon nëse kandidatët plotësojnë kriteret për emërim, i dërgon Kuvendit listën e kandidatëve të kualifikuar sipas renditjes, si dhe listën e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret për emërim. Më tej, parashikimet e nenit 25 i garantojnë institucionit të Kuvendit pavarësinë që gjatë përzgjedhjes së kryetarit dhe/ose anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, **Kuvendi nuk është i detyruar të ndjekë renditjen e paraqitur nga Këshilli i Ministrave.** Për këtë, dispozitat e nenit 25 përcaktojnë se në ato raste kur Kuvendi e vlerëson nevojshme, Kuvendi gjatë përzgjedhjes së kryetarit dhe/ose anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik, nuk është i detyruar të ndjekë renditjen e paraqitur nga Këshilli i Ministrave. Nëse vlerësohet e nevojshme, Kuvendi ka të drejtë të ftojë për intervistë kandidatët që plotësojnë kriteret për emërim. Këto dispozita garantojnë pa ekuivoke pavarësinë e Kuvendit në procesin e përzgjedhjes së kryetarit dhe/ose anëtarëve të KPP. **Për më tepër, dispozitat e nenit 25 të ligjit 162/2020 janë marrë nga Neni 2 i Direktivës së BE-së 89/665 dhe Neni 2 i Direktivës 92/13.**

**Argumenti IX:** Barazimi i statusit të trajtimit financiar dhe vendimarrës të anëtarëve të KPP-së me gjyqtarët e gjykatës administrative të shkallës së parë, nuk mund të kryhet duke patur parasysh natyrën diametralisht të ndryshme të mënyrës së përzgjedhjes, kriterëve të kualifikimit dhe marrëdhënieve institucionale të tyre.

### **Kundërshtimi:**

Cmohet se ashtu siç mbledhja e detyrimeve fiskale është e një rëndësie parësore në shëndoshjen e financave të shtetit, edhe përgjegjëshmëria e shpenzimit të këtyre financave ka të njëjtën rëndësi. Për rolin e rëndësishëm të anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik në luftën kundër shpërdorimit të financave publike, është vlerësuar që anëtarët e KPK-së të përfitojnë pagë mujore dhe/ose shpërblime të tjera financiare në të njëjtën masë me gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Edhe kuadri ligjor i mëparshëm për prokurimet publike pagën e anëtarëve të KPK e përcakton njësoj si ligji nr.162/2020. Ligjvënësi vlerëson rolin e anëtarëve të KPP-së në forcimin të financave publike të shtetit dhe në kontributin e tyre në ngritjen e një sistemi efektiv dhe transparent të prokurimit publik. Transparenca në prokurimet publike është një parim kryesor i sanksionuar nga ligji nr.162/2020 për prokurimin publik. Ky parim bazohet në nenin 23 të Kushtetutës dhe në nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. **Për më tepër, këto dispozita të ligjit 162/2020 janë në përputhje me Nenin 2 të Direktivës së BE-së 89/665 dhe Neni 2 i Direktivës 92/13.**

**Argumenti X:** Kuvendi duhet të kishte vlerësuar mundësinë për kryerjen e një procesi rivlerësimi kalimtar në të gjitha dimensionet për gjithë trupën aktuale të KPP-së, si dhe procedurë të verifikimit të pasurisë dhe figurës, të cdo shtetasi që do të shprehte interesin për të konkuruar për këtë detyrë.

**Kundërshtimi:** Në lidhje me procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për personat që konkurojnë për anëtarë të KPP, ligji nr. 162/2020 shprehet qartë për kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët si dhe përcaktohet qartë se nuk mund të zgjidhet anëtar ose kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik personi që: a) ka qenë i/e dënuar me vendim gjyqësor të formës

së prerë për kryerjen e një vepre penale; b) është larguar nga puna ose nga shërbimi civil me masë disiplinore ose ka ndonjë masë disiplinore në fuqi; c) është nën procedim penal për kryerjen e një vepre penale. Këto dispozita garantojnë pastërtinë e figurës së anëtarëve të KPP. Në lidhje me propozimin e Presidentit për zhvillimin e një procesi rivlerësimi kalimtar në të gjitha dimensionet për gjithë trupën aktuale të KPP-së, vlejme të theksohet se “subjekt i rivlerësimit” janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës, shtuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar. Sipas legjislacionit në fuqi, pjesë e sistemit të rivlerësimit janë të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative. Sistemi i rivlerësimit është ngritur me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës dhe pavarësia e sistemit të drejtësisë. Ndërsa, anëtarët e KPP edhe pse përfitojnë pagë ekuivalente me gjykatësit e shkallës së parë administrative, nuk janë pjesë e sistemit të drejtësisë dhe për pasojë nuk mund të jenë subjekt i rivlerësimit. Nuk duhet konfunduar statusi i magjistratit me pagën. Paga është një element i statusit. Anëtarët e KPK nuk përfitojnë statusin e gjyqtarit Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, por vetëm kanë të njëjtën pagë me ta. **Për më tepër, këto dispozita të ligjit 162/2020 janë në përputhje me Nenin 2 të Direktivës së BE-së 89/665 dhe Neni 2 i Direktivës 92/13.**

#### **Argumenti XI: “Mbi paqartësitë e dispozitave që trajtojnë procedurat e prokurimit”**

Dekreti i Presidentit arsyeton se konstatohet mangësi në nenet 43 dhe 44 të ligjit që normojnë procedurën e kufizuar dhe procedurën konkurruese me negociim, duke pretenduar se nuk specifikohet nëse në këto dy lloje procedurash, njoftimi shpallet dhe a është publik, apo jo?

#### **Kundërshtimi:**

Sipas dispozitave të ligjit nr.162/2020, llojet e procedurave të prokurimit publik janë: a) procedurë e hapur; b) procedurë e kufizuar; c) procedurë konkurruese me negociim, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave të sektorit klasik; ç) partneritet për inovacion; d) dialogu konkurrues; dh) procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit, e cila përdoret vetëm në rastin e kontratave sektoriale; e) procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës; ë) procedurë e hapur e thjeshtuar; f) shërbim konsulence. Për këtë qëllim, ligji e përcakton qartësisht procedurën e kufizuar si procedurë me dy faza, në të cilën mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar, duke dorëzuar një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të një njoftimi, i cili përmban informacionin e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik. Në fazën e dytë të procedurës së kufizuar, ofertë mund të paraqesin vetëm kandidatët e përzgjedhur nga autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me nenin 58 të ligjit nr.162/2020. Autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t'u ftuar që të marrin pjesë në procedurë, në përputhje me parashikimet në këtë ligj. Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, afati minimal i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për pranimin e ofertave është 30 ditë nga data në të cilën është shpallur ftesa për ofertë. Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale, afati kohor për marrjen e ofertave mund të përcaktohet me anë të një marrëveshjeje të përbashkët ndërmjet entit kontraktor dhe kandidatëve të përzgjedhur, me kusht që të gjithë kandidatëve të përzgjedhur t'u jepet kohë e barabartë për të përgatitur dhe dorëzuar ofertat e tyre. Në mungesë të

marrëveshjes për afatin kohor për pranimin e ofertave, afati kohor është të paktën 10 ditë nga data në të cilën është shpallur ftesa për ofertë. **Për më tepër, dispozitat e neneve 43 dhe 44 të ligjit 162/2020 janë marrë përkatësisht nga Neni 28 dhe Neni 29 i Direktivës së BE-së 2014/24 dhe Neni 46 i Direktivës 2014/25.**

**Argumenti XII:** Neni 47 i ligjit nr. 162/2020, duhet të plotësohet me qëllim që të shmanget cdo mundësi e keqzbatimit apo keqinterpretimit në praktikë.

#### **Kundërshtimi:**

Procedura me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës mund të përdoret për kontratat publike të punëve, mallrave ose shërbimeve kur në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme të hapura ose të hapura të thjeshtuara, shërbimit të konsulencës ose procedurës së kufizuar apo në përgjigje të një procedure të publikuar për konkurrim të lidhur me aktivitetet sektoriale sipas dispozitave të ligjit nr.162/2020, nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje, ose kur ofertat apo kërkesat për pjesëmarrje të dorëzuara kanë qenë të papërshtatshme. Në çdo rast, dispozitat e ligjit nr.162/2020 përcaktojnë qartë se kushtet fillestare të kontratës nuk duhet të kenë pësuar ndryshime thelbësore.

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor mund të përdorë procedurën me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit, kur në përgjigje të procedurës me shpallje paraprake të njoftimit nuk është paraqitur asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje ose ato që janë dorëzuar kanë qenë të papërshtatshme, duke pasur parasysh që kushtet fillestare të kontratës të mos kenë pësuar ndryshime thelbësore.

Sipas dispozitave të ligjit nr.162/2020 një ofertë konsiderohet si e **papërshtatshme**, kur ajo nuk ka lidhje me kontratën dhe duket qartë që nuk mund të plotësojë, pa pësuar ndryshime thelbësore, nevojat dhe kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, të specifikuar në dokumentet e tenderit. Kërkesa për pjesëmarrje konsiderohet si e papërshtatshme kur operatori ekonomik në fjalë ndodhet në kushtet e skualifikimit, sipas nenit 76 të ligjit nr.162/2020, ose nuk përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor sipas nenit 77 të ligjit nr.162/2020. **Për më tepër, dispozitat e nenit 47 të ligjit 162/2020 janë marrë nga Neni 32 i Direktivës së BE-së 2014/24 dhe Neni 50 i Direktivës 2014/25.**

**Argumenti XIII:** Nenet 51, 52, 57, 71 të ligjit nr.162/2020 janë të papranueshëm, pasi shkelin parimet kushtetuese të konkurrencës dhe nismës së lirë si dhe barazisë përpara ligjit në procedurat e prokurimit publik për arsye se autoritetet kontraktore nuk kanë detyrim që të shpallin një njoftim kontrate në rastet kur gjatë një procedure të hapur ose të kufizuar janë dorëzuar vetëm oferta të parregullta apo të papranueshme.

#### **Kundërshtimi:**

Autoritetet kontraktore mund të përdorin një procedurë konkurruese me negociim ose dialog konkurrues në rastet kur për të përmbushur nevojat e autoritetit kontraktor është e nevojshme të përshtaten zgjidhjet ekzistuese, që autoritetet kontraktore i kanë në dispozicion, kur ato përfshijnë projektim ose zgjidhje inovatore, kur kontrata nuk mund të jepet pa negociim paraprak për shkak të rrethanave specifike që lidhen me natyrën, kompleksitetin, kuadrin juridik dhe financiar ose për shkak të rreziqeve që shoqërojnë ato, kur specifikimet teknike nuk mund të përcaktohen me saktësinë e duhur nga autoriteti kontraktor bazuar në standarde të miratuara apo duke iu referuar specifikimeve të caktuara, në përputhje me parashikimet e këtij ligji. Në rrethanat kur për kontratat e punëve, mallrave ose shërbimeve kur gjatë një procedure të hapur

ose të kufizuar janë dorëzuar vetëm oferta të parregullta apo të papranueshme, autoritetet kontraktore nuk kanë detyrim që të shpallin një njoftim kontrate për sa kohë që përfshijnë në procedurë të gjithë ofertuesit që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në ligjin nr.162/2020 dhe që gjatë një procedure të mëparshme të hapur ose të kufizuar kanë dorëzuar oferta në përputhje me kërkesat formale të procedurës së prokurimit. Për këtë, konsiderohen oferta të parregullta, ato oferta që nuk janë në përputhje me dokumentet e tenderit, si dhe nuk respektojnë detyrimet ligjore që vijnë nga legjislacioni i posaçëm në varësi të objektit të prokurimit. Më konkretisht, sipas dispozitave të nenit 51 konsiderohen oferta të papranueshme ato oferta, të cilat janë dorëzuar me vonesë, janë anomalisht të ulëta dhe të paargumentuara, tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të përcaktuar dhe të dokumentuar përpara fillimit të procedurës së prokurimit.

Dispozitat e neneve 51, 52, 57, dhe 71 të ligjit nr.162/2020 janë të përcaktuara qartë dhe në harmoni të plotë me parimet kushtetuese të konkurenencës dhe nismës së lirë si dhe barazisë përpara ligjit. **Për më tepër, dispozitat e neneve 51, 52, 57, dhe 71 të ligjit 162/2020 janë marrë përkatësisht nga Nenet 26 dhe 33, të Direktivës 2014/24 dhe Nenet 44 dhe 51 të Direktivës 2014/25.**

**Argumenti XIV:** Në rastin e dispozitave të nenit 76, ligji ka shtrembëruar institutin penal të rehabilitimit, duke përfshirë një interpretim të ri të këtij instituti përmes këtij ligji i cili hyn në llojin e atyre ligjeve që miratohen me shumicë të thjeshtë, duke rënë ndesh me afatet e rehabilitimit që parashikohen nga Kodi Penal, si një normë në nivel më të lartë në hierarkinë e akteve, e miratuar me shumicë të cilësuar.

#### **Kundërshtimi:**

Dispozitat e nenit 76 të ligjit nr. 162/202 janë në harmoni me parashikimet e legjislacionit penal. Ekzekutimi i vendimeve penale përcaktohet në Kodin e Procedurës Penale dhe jo në legjislacionin përgjegjës për prokurimin publik. **Për më tepër, dispozitat e nenit 76 të ligjit 162/2020 janë marrë nga Neni 57 i Direktivës së BE-së 2014/24 dhe Neni 80 i Direktivës 2014/25.**

#### **Argumenti XV: “Lidhur me ankimin administrativ”**

Dekreti i Presidentit argumenton se ligjëvënësi duhet të konsiderojë normimin e sjelljes dhe veprimtarisë ekonomike në sektorin e prokurimit publik, ashtu sikurse në secilën fushë të jetës në vendin tonë, me qëllim zgjidhjen e problematikave të ndeshura, duke synuar saktësimin e nocioneve dhe rregullimeve ligjore në pajtim me parimet kushtetuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, të cilat do të shërbejnë si mjet për disiplinimin e aktorëve pjesëmarrës.

#### **Kundërshtimi:**

E drejta për ankim efektiv është një e drejtë themelore e njeriut dhe nënkupton të drejtën e individit për ankim, ekzistencën e një organi të caktuar për shqyrtimin e ankimit, pranimin e pakushtëzuar të ankimit për shqyrtim, afate të arsyeshme për shqyrtimin e tij, një shqyrtim objektiv, kontroll gjyqësor, si kontroll përfundimtar ndaj ankimit si dhe mundësinë e rehabilitimit të mundshëm si pasojë e pranimit eventual të ankimit.

Shihet qartë, që KREU XIV i ligjit nr.162/2020 normon qartësisht dhe pa ekuivoke të drejtën e ankimit. Sipas nenit 109, pas shqyrtimit administrativ, operatorët ekonomikë kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit në përputhje me nenin 121 të ligjit nr.162/2020, si dhe në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi në gjykatë nuk pezullon procedurat konkurruese, lidhjen e kontratës ose ekzekutimin e detyrimeve mes palëve.

Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

Në procedurat e prokurimit me faza mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit për këtë vendim.

Në procedurat e prokurimit me faza nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

Në rastin e procedurave për rihapjen konkurrimit për lidhjen e një kontrate, në bazë të një marrëveshjeje kuadër me disa operatorë ekonomikë, me procedurë prokurimi mbi kufirin e lartë monetar, afati për paraqitjen e ankesave është 10 ditë nga data e publikimit të njoftimit të fituesit të kontratës. Në rastin e kontratave të lidhura në bazë të një marrëveshjeje kuadër, me vlerë nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

Në rastin e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 30 ditëve nga dita e publikimit të njoftimit të fituesit. Nëse është publikuar njoftimi vullnetar për transparencë, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të paraqesin ankesën e tyre brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, sa i takon plotësimit të kushteve për përdorimin e kësaj procedure prokurimi, si dhe përmbajtjes së dokumenteve të tenderit.

Në rastin e konstatimit të një kontrate publike të lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në këtë ligj dhe/ose në rastin kur nuk është publikuar njoftimi i fituesit ose njoftimi i kontratës së nënshkruar, afati për paraqitjen e një ankese lidhur me këtë kontratë është 60 ditë nga dita e konstatimit të saj, por jo më vonë se 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët

ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të dispozitave të nenit 113 të ligjit nr.162/2020, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.

Ankimuesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimesit nuk i kthehet tarifa e ankesës. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.

Në lidhje me pavlefshmërinë e kontratave, dispozitat e nenit 119 përcaktojnë në mënyrë shterruese se një kontratë do të konsiderohet absolutisht e pavlefshme nëse një autoritet ose ent kontraktor ka nënshkruar një kontratë pa publikuar paraprakisht shpalljen e njoftimit të kontratës, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr.162/2020. Kur nuk janë zbatuar parashikimet e ligjit nr.162/2020 në lidhje me zbatimin e procedurave të ankimit, duke privuar personat e interesuar për të ushtruar të drejtën e tyre për ankim. Kur nuk janë zbatuar rregullat për rihapjen e garës për kontratat e lidhura në bazë të një marrëveshjeje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara dhe në sistemin dinamik të blerjeve të ndarë në kategori. Kur kontrata është nënshkruar në kushtet e konfliktit të interesit dhe nëse një autoritet ose ent kontraktor ka nënshkruar një kontratë duke mos respektuar vendimin e dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Kontrata mund të mos shpallet absolutisht e pavlefshme edhe nëse ajo është lidhur jo sipas parashikimeve të dispozitave të nenit 119, nëse Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të të gjitha aspekteve përkatëse, çmon se shpallja e pavlefshme e kësaj kontrate mund të çeshtjet thelbësore të interesit të përgjithshëm. Interesat ekonomike të lidhura drejtpërdrejt me kontratën në fjalë, si kostot për shkak të vonesave në zbatimin e kontratës, kostot për shkak të shpalljes së një procedure të re prokurimi, kostot për shkak të ndryshimit të operatorit ekonomik që do të zbatojë kontratën, si edhe kostot për shkak të detyrimeve ligjore si pasojë e pavlefshmërisë nuk konsiderohen çështje thelbësore të interesit të përgjithshëm.

Në rastin e konstatimit të situatave sipas dispozitave të pikës 2 të nenit 119 të ligjit nr. 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë të aplikojë zbatimin e masave të tjera administrative, si dënimin me gjobë të autoritetit ose entit kontraktor për shkeljet e konstatuara; urdhërimin e autoritetit kontraktor për shkurtimin e afatit të zbatimit të kontratës për të minimizuar dëmin e shkaktuar. Në këto raste, gjoba duhet të vendoset në raport me vlerën e kontratës së nënshkruar, por, në çdo rast, jo më shumë se 10% e kësaj vlere. Rregullat e posaçme për këtë proces përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. **Për më tepër, dispozitat e neneve të ligjit 162/2020, cilat lidhen me ankimin administrativ, të cituara në këtë dekret, konkretisht Nenet 111, 112, 115, 118, dhe 119 janë respektivisht në përputhje me Nenet 1, 2, dhe 2d, të Direktivës 89/665 dhe Nenet 1, 2 dhe 2d të Direktivës 92/13.**



\*\*\*

#### **IV.PËRFUNDIM**

Në përfundim të pyetjeve dhe diskutimeve, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm vendosi rrëzimin e Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11942, datë 27.01.2021, “Për kthimin e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik””, dhe ia përcjell raportin për votim seancës plenare.

**RELATORE**

**KRYETARI**

**KLOTILDA BUSHKA**

**ULSIMANJA**